



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 153 prot.

Tiranë, më 13.01.2020

URDHËR

Nr. 9, datë 13.01.2020

PËR  
MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË  
INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË MINISTRINË E  
DREJTËSISË”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9000 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të nenit 46, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Ministrinë e Drejtësisë”, sipas aktit bashkëlidhur.
2. Shfuqizimin e Rregullore së mëparshme të miratuar me Urdhrin nr.1143/8, datë 27.06.2011.
3. Ngarkohet Autoriteti i Përgjegjës për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri subjekteve të Ministrisë së Drejtësisë që kanë detyrimin për zbatimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
  
Etilda Gjonaj (Saliu)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË**

**RREGULLORE**

**PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E  
FUNKSIONEVE PUBLIKE NË MINISTRINË E DREJTËSISË**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Baza ligjore**

Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve” në Ministrinë e Drejtësisë, bazohet në ligjin nr.8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse të miratuara në zbatim të tyre.

**Neni 2**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është garantimi i një vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut si dhe ushtrimi i funksioneve të zyrtarëve publik dhe punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë jo në kushtet e konfliktit të interesit.

**Neni 3**

**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për zbatimin e detyrimeve ligjore për deklarimin e pasurive si dhe identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajnimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

## Neni 4

### Përkufizime

1. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në Ministrinë e Drejtësisë.

2. "Person i lidhur me një zyrtar të MD-së" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, me zyrtarin e Ministrisë, sipas përcaktimit të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

3. "Parim i proporcionalitetit" është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari të Ministrisë, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

4. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Konflikti i interesit përfshin edhe disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) "Konflikt faktik i interesit" është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare.

b) "Konflikt në dukje i interesit" është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.

c) "Konflikt i mundshëm i interesit" është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

ç) "Konflikt rast për rast i interesit" është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë.

d) "Konflikt i vazhdueshëm i interesit" është gjendja në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

## Neni 5

### Fusha e zbatimit

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

- a) Çdo zyrtar, sipas përcaktimit të këtij termi në pikën 1 të nenit 4 të kësaj Rregullorje, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte e kontrata administrative, i cili ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në një vendimmarrje, apo që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9367 datë 07.04.2005 dhe në ligjin nr.9049 datë 10.04.2003, dhe në Rregulloren e Brendshme të Ministrisë, sipas hierarkisë duke filluar nga:
- i. Ministri i Drejtësisë;
  - ii. Zëvendësministrat e Drejtësisë;
  - iii. Drejtori i Kabinetit
  - iv. Këshilltarët e Ministrit të Drejtësisë;
  - v. Sekretari i Përgjithshëm;
  - vi. Drejtor i Përgjithshëm;
  - vii. Drejtor Drejtorie;
  - viii. Përgjegjës Sektori;
  - ix. Magjistrat të komanduar në Ministrinë e Drejtësisë;
  - x. Specialist në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe çdo punonjës tjetër që barazohet me të dhe trajtohet sipas dispozitave të "Kodit të Punës";
  - xi. Cdo zyrtar tjetër i Institucioneve të Varësisë të Ministrisë së Drejtësisë, i ndërmarrjeve a shoqërive tregtare me pjesëmarrje kontrolluese të kapitalit shtetëror, organizatat jofitimprurëse dhe persona të tjerë juridik, të kontrolluar nga Ministria e Drejtësisë, ose nga subjektet në varësi të kësaj Ministrie;
  - xii. Çdo zyrtar tjetër, sipas përcaktimit të nenit 4, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
  - xiii. Personat e lidhur me zyrtarin, në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- b) Dispozitat e kësaj Rregullorje zbatohen për aq sa është e mundur nga zyrtarët e institucioneve të varësisë të Ministrisë së Drejtësisë.

## Neni 6

### Vendimmarrja dhe çastet paraprake të vendimmarrjes

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

- a) Vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit.

b) Vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:

i) hartimin e projekt-aktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin e këtij projektakti organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;

ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, për këtë projektakt normativ nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;

iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;

iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;

v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetej përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre;

vi) çdo rast tjetër, në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë.

## **Neni 7**

### **Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt**

1. Një zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 6, të Rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:

a) roli i zyrtarit urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negociimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;

b) zotërimin e informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive për subjektet dhe /ose ish-subjektet e MD -së, të dhëna për kuadrin rregullator, informacione personale, informacione për politikën ekonomike dhe administrimin financiar etj;

c) çdo shkak tjetër, në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të Ministrisë.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga Autoriteti Përgjegjës i Ministrisë së Drejtësisë, si dhe nga zyrtarët - eprorë në Ministrinë e Drejtësisë.

4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.

5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private, në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, veprohet sipas parashikimit të nenit 37, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

## **Neni 8**

### **Interesat privatë**

1. Interesat privatë të një zyrtari janë interesat që parashikohen nga neni 5, i ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, konkretisht:

a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit, apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;

dh) marrëdhënie:

i) familjare apo të bashkëjetesës;

ii) të komunitetit;

iii) etnike;

iv) fetare;

v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;

e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5, të ligjit 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4, të nenit 3, të ligjit të lartpërmendur.

## KREU II

### PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

#### Neni 9

##### **Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit**

1. Çdo zyrtar i Ministrisë, sipas përcaktimit të këtij termi në pikën 1, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, që përgatit dhe merr pjesë në vendimmarrje për një akti ligjor, nënligjor, normativ apo administrativ, që lidh kontrata shërbimi apo investimi, që përfaqëson ministrinë në marrëdhënie me të tretët, që mbikëqyr apo përdor fonde publike, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tij funksionale ose të ngarkuara përkohësisht, **detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak**, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat, që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesit.
2. Deklarimi rast për rast, i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtarët kur kjo kërkohet nga eprori apo institucioni epror.
3. Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

4. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimmarrje për një akt. Deklarimi me shkrim nuk është i domosdoshëm kur deklaramet verbale të zyrtarit janë të regjistrueshme dhe të dokumentueshme, sipas procedurave të përcaktuara me ligj ose akte të tjera ligjore.

#### **Neni 10**

##### **Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë**

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit në Ministrinë e Drejtësisë është:
  - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni, në vecanti e eprorit të tij;
  - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari dhe punonjësi të Ministrisë, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

#### **Neni 11**

##### **Lëshimi i autorizimit nga zyrtari**

1. Ministria e Drejtësisë vë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit, që këta duhet të lëshojnë në zbatim të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar. Modeli i autorizimit, në formë dhe përmbajtje, është miratuar nga ILDKPKI dhe duhet të plotësohet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës për çdo zyrtar.
2. Autorizimet dorëzohen pranë Autoritetit Përgjegjës në Ministrinë e Drejtësisë dhe administrohen po nga ky Autoritet.

#### **Neni 12**

##### **Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave.**

1. Autoritet Qendror Përgjegjës për zbatimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Autoriteti ose struktura përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 dhe të kësaj Rregullorje, sipas hierarkisë në Ministrinë e Drejtësisë janë:
  - a) Ministri i Drejtësisë;
  - b) Zëvendësministrat e Drejtësisë;
  - c) Drejtor Kabineti në Ministrinë e Drejtësisë;



- d) Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- e) Drejtorët e Drejtorive të Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë;
- f) Drejtorët e Drejtorive në Ministrinë e Drejtësisë;
- g) Përgjegjësit e sektorëve.

3. Autoriteti Përgjegjës në Ministrinë e Drejtësisë, sipas pikës “b” të nenit 41, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në këtë ligj, në Udhëzimin nr.1, datë 27.6.2014, si dhe në nenin 13 të kësaj Rregulloreje si më poshtë vijon, ngrihet me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

4. Institucionet e Varësisë marrin masa për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar. Gjithashtu Institucionet e Varësisë miratojnë Rregulloren e vet për parandalimin e konfliktit të interesave.

5. Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të Autoritetit Përgjegjës, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI.

### **Neni 13**

#### **Detyrat e Autoritetit Përgjegjës në Ministrinë e Drejtësisë**

Autoriteti Përgjegjës në Ministrinë e Drejtësisë, kryen detyrat e mëposhtme:

- a) Mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë;
- b) Shpërndan dhe administron autorizimet e detyrueshme për t’u lëshuar nga zyrtarët e institucionit, sipas pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe nenit 11 të kësaj rregulloreje;
- c) Njofton me shkrim ILDKPKI për largimet apo emërimet e reja të zyrtarëve të cilët mbartin detyrim për deklaram të interesave private;
- d) I paraqet ILDKPKI çdo vit për vitin pararendës, jo më vonë se data 31 janar, një raport mbi veprimtarinë e kryer nga Autoriteti Përgjegjës në zbatim ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, duke përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklaramin e interesave private periodike;
- dh) Shtron çështje dhe kërkon këshilla nga ILDKPKI për zbatimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- e) Plotëson dhe administron regjistrin përkatës për regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesit;
- f) U sugjeron zyrtarëve dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
  - i.konfliktit rast për rast të interesit;

ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

g) Kryen verifikimin e interesave private të zyrtarëve, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë, sipas rastit eprorin e drejtpërdrejtë dhe Ministrin;

gj) Dorëzon deklaratat periodike vjetore në ILDKPKI brenda datës 15 prill të çdo viti;

h) Mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave nga ILDKPKI në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;

i) Angazhohet për informimin, këshillimin e trajnimin e zyrtarëve në lidhje me ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më efektiv të konfliktit të interesave;

j) Merr masa për të siguruar aksesin e informimin e publikut me të dhënat dhe me dokumentet zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit;

k) në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse:

i) Merr masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në kushtet e konfliktit të interesit,

ii) Siguron transparencën me publikun për vendimmarrjet e kryera nga institucioni në lidhje me konfliktin e interesave.

iii) Përfshihet për përmirësime në akte të tjera ligjore dhe nënligjore, kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;

l) Mbledh deklaratat e interesave private të plotësuara nga zyrtarët e Ministrisë dhe i dërgon pranë ILDKPKI brenda 15 ditëve nga përmbushja e afatit ligjor për dorëzimin e këtyre deklaratave nga subjekti deklarues.

m) Bën me dije zyrtarët dhe punonjësit e Ministrisë për çdo Urdhër apo Udhëzim të Ministrit dhe ILDKPKI;

n) Mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit, kontrollit dhe të hetimit administrativ të ILDKPKI në MD;

nj) Ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj Rregulloreje, Udhëzimit nr.1, datë 27.6.2014, akteve të tjera në zbatim të ligjit nr.9366, datë 07.04.2005 dhe ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, që nxjerr ILDKPKI.

## Neni 14

### Administrimi i dokumentacionit nga Autoriteti Përgjegjës

1. Dokumentacioni i përdorur nga Autoriteti Përgjegjës, në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe në zbatim të kësaj Rregulloreje, është dokumentacion zyrtar. Në rast largimi nga detyra, bëhet dorëzimi i gjithë dokumentacionit me procesverbal sipas rregullave të caktuara.

2. Me qëllim administrimin sa më të mirë të dokumentacionit nga Autoriteti Përgjegjës, krijohen dosje të veçanta me përmbajtje si vijon:

a) Dosja nr.1, me titull “Për aktet ligjore e nënligjore”:

- Ligji nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar;
- Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
- Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Ligji nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” i ndryshuar;
- Urdhëra dhe udhëzime të ILDKPKI;
- Botime të tjera të ILDKPKI.

b) Dosja nr.2, me titull, “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave”:

- Regjistri për regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
- Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët sipas nenit 10, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
- Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
- Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë;

c) Dosja nr.3, me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe të interesave të zyrtarëve, që bartin detyrim për deklarim në ILDKPKI”:

- Regjistri themeltar alfabetik nr.1, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
- Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarim;
- Kopje të shkresave (procesverbalet e dorëzimit) për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
- Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
- Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit;
- Libri i regjistrimit të shkresave të nisura dhe të ardhura.

### **Neni 15**

#### **Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave**

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë, krijohet regjistri me të njëjtin emër sipas formatit tip të miratuar nga ILDKPKI.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave, administrohet nga Autoriteti Përgjegjës i Ministrisë së Drejtësisë.

### **Neni 16**

#### **Regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave**

Autoriteti Përgjegjës, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat.

### **Neni 17**

#### **Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave privatë**

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të Ministrisë bëhet sipas kërkesave të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarim të interesave private periodike janë:
  - a) Ministri i Drejtësisë;
  - b) Zëvendësministrat e Drejtësisë;

- c) Drejtor i Kabinetit të Ministrisë së Drejtësisë;
- d) Këshilltarët e Ministrit të Drejtësisë;
- e) Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë;
- f) Drejtorët e Drejtorive të Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë;
- g) Drejtorët e Drejtorive të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Gjithashtu mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhor të zyrtarëve të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni.

4. Çdo zyrtar, i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në ILDKPKI, është i detyruar që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni të plotësojë dokumentin zyrtar “Deklaratë pas largimit nga funksioni”.

### **Neni 18**

#### **Llojet e interesave privatë që deklarohen periodikisht**

Interesat privat që deklarohen periodikisht janë të përcaktuara në nenin 4, të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

### **Neni 19**

#### **Mbrojtja për dhënien e informacioneve**

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

a) zyrtari, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues, dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;

b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) zyrtari është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;

b) vetëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;

c) kur nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij;

d) kur asnjëra nga zgjidhjet e nenit 23 të kësaj rregullorje nuk është e mundur.

dh) kur nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i Ministrisë të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga eprori ose nga institucioni epror, të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen në çdo rast publike.

## **Neni 20**

### **Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit të interesave për çështje të veçanta**

Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarët, të përcaktuar në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", zbatohen edhe për personat e lidhur me ta, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit, bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 24 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

1. Ministri dhe Zëvendësministrat e Drejtësisë :

a) nuk mund të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizatë tjetër, përjashtuar organizatat politike dhe shtetërore, si dhe në rastet kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;

b) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, si dhe profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni;

c) nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

ç) nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj;

d) nuk mund të lidhin kontrata ndërmjet, çdo institucioni publik nga njëra anë dhe nga ana tjetër shoqërisë/ve tregtare, shoqërisë së thjeshtë a ortakërisë, në të cilën Ministri apo Zëvendësministri, zotëron aksione ose pjesë në kapital, pavarësisht nga sasia e aksioneve ose pjesëve të kapitalit që zotëron.

2. Zyrtarët e tjerë të përcaktuar në pikën 2, të nenit 17, të kësaj Rregullorje:

a) nuk mund të jenë drejtues në organizatat fitimprurëse;

b) nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, kur:

i) këta ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar;

ii) me akte të nxjerra nga ai;

iii) ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, me akte të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri a organizata apo mbi shoqëri ose organizata të tjera që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, përjashtuar rastet kur ky pozicion në shoqëri ose organizatë vjen për shkak të funksionit dhe/ose të statusit;

c) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e:

i) personit fizik tregtar;

ii) ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme;

iii) profesioneve të lira të avokatisë, noterisë, arbitrit, ndërmjetësit, administratorit të falimentit, ekspertit të liçencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a të përfaqësuesit të organizatave fitimprurëse;

ç) nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

d) nuk mund të lidhin kontrata ndërmjet, çdo institucioni publik nga njëra anë dhe nga ana tjetër shoqërisë/ve tregtare, shoqërisë së thjeshtë a të ortakërisë, në të cilën ata zotërojnë aksione ose pjesë në kapital, pavarësisht nga sasia e aksioneve ose pjesëve të kapitalit që zotërojnë;

dh) mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c", të nenit 27, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005.

3. Pavarësisht përcaktimeve të mësipërme, ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë apo institucioneve të varësisë, nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik, apo ndonjë formë tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:

a) zyrtari që ushtron funksionet në këtë institucion ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës;

b) ky zyrtar ka një interes privat, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

## Neni 21

### **Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale**

1. Është e ndaluar që një zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë, të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në Ministri, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

a) “Dhurata”, sipas kësaj Rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004.

b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.

2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.

3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.

4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004.

5. Në asnjë rast zyrtari i Ministrisë së Drejtësisë nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.

6. Përfshihen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

## Neni 22

### **Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin**

1. Person i lidhur me zyrtarin e Ministrisë, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenin 20, të kësaj Rregulloreje, janë përkatësisht: bashkëshorti/ja bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit, të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es;



2. Person i lidhur me zyrtarin, për kufizimet e interesave private të zyrtarëve të përcaktuara në nenin 21 të kësaj Rregullorje janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es, si dhe çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
3. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e Ministrisë së Drejtësisë, të përcaktuara në nenin 20 dhe 21, zbatohen edhe për personat e lidhur, të përcaktuar në pikën 1 dhe 2, të këtij neni.
4. Përsa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e Ministrisë së Drejtësisë dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtpërdrejtë parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005.
5. Personi i lidhur me zyrtarin e Ministrisë, nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo formë, nëse veprimtaria përputhet ose pritët me sferën e juridiksionit të zyrtarit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur.

### **Neni 23**

#### **Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave**

1. Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët e Ministrisë, bëhen sipas kreut IV, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Disa nga mënyrat bazë të mënjanimin të konfliktit të interesit janë:
  - T'i kufizohen zyrtarit informacione të caktuara, të cilat lidhen me ushtrimin e funksionit të tij.
  - Të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti të mundshëm interesi.
  - Të mos lejohet zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.
  - Të rishikohen ose të ndryshohen detyrat dhe kompetencat e zyrtarit.
  - Të transferohet zyrtari në një detyrë tjetër, që shmang rënien në konflikt interesi.
  - Të merren masa për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione në të cilat mund të lindin ose ka konflikt interesi.
  - Në rastin e një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anulohen ose revokohen aktet e marra nga zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur për të parandaluar kështu pasojat që mund të sjellë ky konflikt interesi.
  - Anulimi ose revokimi i aktit të marrë mund të bëhet edhe në rastet kur është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme.

- Anulimi ose revokimi i një akti nuk mund të bëhet nga eprori i zyrtarit, në rastin kur ai vlerëson se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi, i aktit i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

#### **Neni 24**

##### **Sanksionet**

Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, në Urdhrin nr.28, datë 13.03.2014 dhe në këtë Rregullore, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 44, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005. Masat disiplinore sipas nenit 45, të ligjit të mësipërm, zbatohen në përputhje me legjislacionin i cili rregullon marrëdhëniet e punës ose statusin e zyrtarit.

#### **Neni 25**

##### **Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës**

1.Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve Ministrisë së Drejtësisë, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt, që synon cenimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 dhe në këtë Rregullore.

2.Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë Rregullore, zbatohen dispozitat konkrete, të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

#### **Neni 26**

##### **Njoftim i Rregullores punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë**

1. Autoriteti Përgjegjës merr masa për njohjen e Rregullores nga çdo zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë jo më vonë se 1 (një) muaj nga miratimi i saj nga Ministri i Drejtësisë.
2. Rregullorja i bëhet e njohur çdo punonjësi të Ministrisë së Drejtësisë në rastet kur kërkohet nga punonjësi. Kopja u bëhet e ditur të gjithëve që në momentin kur punësohen në këtë institucion, apo në rastet kur ka përditësim dhe ndryshim të Rregullores në respektim të akteve ligjore që miratohen.

#### **Neni 27**

##### **Hyrja në fuqi dhe shpallja publike**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë me miratimin e saj. Gjithashtu, pas firmosjes nga titullari i institucionit, të merren masa që Rregullorja të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë.